



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:136482

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04001450

P.nr.145/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj, bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe zyrtaren ligjore Mirlinda Gashi, si procesmbajtëse, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh. Sh. nga fshati ... – Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1110/2022 të datës 22.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar i cili ishte i hapur për publikun më datë 03.02.2023, në të cilën prezent ishin prokurori i shtetit H. B. dhe i pandehuri Sh. Sh., më datën 07.02.2023 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 22.02.2023, e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

- **I pandehuri Sh. Sh.**, nga babai N. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë K., i lindur me datë ... në Skenderaj, me vendbanim në fshatin ... – Komuna Skenderaj, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-baba i një fëmije, i punësuar në Mal të Zi-..., i gjendjes së mesme ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Gjatë periudhës kohore nga 12.05.2022, e gjerë me 14.05.2022 në fshatin ... – Komuna Skenderaj, në rrugën magjistrale Drenas – Skenderaj në Rr.”...”, me qëllim që vetës t’i sigurojë të mira materiale ka marrë pasurinë e huaj, në atë mënyrë që me veturën e tipit “K.”, me targa të Gjermanisë ..., ka dërguar gjerë të lokali i garazhit në Rr.”...”, e ka lënë veturën përpara e pastaj duke e përdorur forcën ka hapur derën e rrethojës ku gjendej garazhi për auto pjesë, pronë e të dëmtuarit F. M., ka hyrë

në brendinë e oborrit ku i ka marrë 3 diferencijale të kamionetës, 4 feder shirita të kamionit, rreth 30 grepa të veturave, 3 ndërrues të shpejtësisë të Xhipave, 2 diferencile për Mercedes dhe pas kësaj duke përdorur forcën e ka hapur dritaren e lokalit, ka hyrë brenda lokalit dhe nga i njëjti i ka marrë ato pjesë të ndryshme për vetura nga të cilat sipas të dëmtuarit janë marrë 700-800 kg hekur dhe alumin, e me pasë ato pjesët e marra i ka bartur në një skrap në Skenderaj ku i ka shitur.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, e lidhur me nenet 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, 453 par.1, 463 par.1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin :

- E G J Y K O N -

I.- Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe **dënim me gjobë në shumën prej treqind (300.00) Euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ditës së plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i pandehuri që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20.00) Euro si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.- Pala e dëmtuar F. M. nga fsh...-Komuna Skenderaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes –

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm më datë 26.08.2022 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1110/2022, të datës 22.08.2022, kundër të pandehurve : 1. V. K., me vendbanimi në Rr.”...”, në fshatin ... – Komuna Skenderaj dhe 2. Sh.Sh. nga fshati ... – Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 03.02.2023 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent prokurori i shtetit H. B. dhe i pandehuri i dytë Sh. Sh., prezencën e të cilit e ka siguruar Policia e Kosovës pas ndalimit dhe arrestimit të të njëjtit me datë 02.02.2023, në pikën kufitare KULL, që lidhet me Malin e Zi, vepruar sipas urdhër arrestit të lëshuar nga kjo gjykatë me datë 23.01.2023, ndërsa nuk ka prezantuar i pandehuri i parë V. K., për të cilin në bazë të parashtresës me shkrim të datës 26.01.2023 nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Skenderaj, pas verifikimit të adresës së këtij të pandehuri është konstatuar se i njëjti gjendet në Mal të Zi në adresë të pasaktësuar.

- Duke qenë se i pandehuri i parë V. K. gjendej në Mal të Zi në adresë të pasaktësuar, Gjykata në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 36 par.1 dhe 2 të KPP-së, pas dëgjimit të palëve-Prokurorit të shtetit dhe të pandehurit të dytë Sh. Sh., ka marrë Aktvendim e më pas ka nxjerrë Aktvendim të veçantë procedural P.nr.145/2022 datë 09.02.2022, me të cilin ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehuri V. K., për të cilin do të zhvillohet procedurë e veçantë penale me qëllim të efikasitetit dhe mos zvarritjes së procedurës penale.

- Gjykata ka vazhduar me shqyrtimin fillestar ndaj të pandehurit të dytë Sherif Shabani ashtu që, e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale i pandehuri ka deklaruar se dëshiron të mbrohet vetë.

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë –

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata të pandehurin Sh. Sh. e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficinet e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsërisë

veprimet e tilla dhe në fund kërkoi nga gjykata që t'i shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë, duke shtuar së lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkoi falje, njëheritë kërkoi nga gjykata që të ketë parasyshë rrethanat ndaj tij se është njeri familjarë, mbajtës kryesor i familjes, dhe baba i një fëmije.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që ta aprovoj këtë pranim fajësie.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri Sherif Shabani dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par.4 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuzë ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri Sh. Sh., pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të pandehurin, siç ishin : Raporti i oficerit policor Nr.2022-BF-0211 i datës 14.05.2022, Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të dëmtuarin – Florent Mala Nr.2022-BF-0211 i datës 14.05.2022 dhënë në Policin e Kosovës – Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të pandehurin – Sh. Sh. Nr.2022-BF-0211 i datës 14.05.2022 dhënë në Policin e Kosovës – Stacioni Policor në Skenderaj, Përmbajtja e dosjes së forenzikës së bashku me Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes Nr.2022-BF-0211 i datës 14.05.2022 dhe Foto albumi gjithsej tetë (8) faqe, i Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Mitrovicë-Njësia e Forenzikës si dhe nga fotodokumentaoni dhe vështrimi në të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit Sh. Sh. përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 KPRK-së, ngase i njëjti gjatë periudhës kohore nga 12.05.2022, e gjerë me 14.05.2022 në

fshatin Morinë – Komuna Skenderaj, në rrugën magjistrale Drenas – Skenderaj në Rr.”...”, me qëllim që vetës t’i sigurojë të mira materiale ka marrë pasurinë e huaj, në atë mënyrë që me veturën e tipit “K.”, me targa të Gjermanisë ..., ka dërguar gjerë të lokali i garazhit në Rr.”...”, e ka lënë veturën përpara e pastaj duke e përdorur forcën ka hapur derën e rrethojës ku gjendej garazhi për auto pjesë, pronë e të dëmtuarit F. M. ka hyrë në brendinë e oborrit ku i ka marrë 3 diferencijale të kamionetës, 4 feder shirita të kamionit, rreth 30 grepa të veturave, 3 ndërrues të shpejtësisë të Xhipave, 2 diferencile për Mercedes dhe pas kësaj duke përdorur forcën e ka hapur dritaren e lokalit, ka hyrë brenda lokalit dhe nga i njëjti i ka marrë ato pjesë të ndryshme për vetura nga të cilat sipas të dëmtuarit janë marrë 700-800 kg hekur dhe alumin, e me pasë ato pjesët e marra i ka bartur në një skrap në Skenderaj ku i ka shitur, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin Sh. Sh. si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, po ashtu rrethanë lehtësuese gjykata mori edhe rrethanat e tij personale se i njëjti është familjar-mbajtës kryesor i familjes, i martuar-baba i një (1) fëmijë, pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese në rastin konkret gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë të shprehura e në të tendencë të rritjes së tyre.

- Me rastin e matjes së dënimit për të pandehurin gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nënpar. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 72 par.1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, vendosi që të zbutë dënimin ndaj tij duke marrë marrë parasyshë pranimin në tërësi të fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur si dhe premtimin se i njëjti nuk do t’i përsërisë veprimet e tilla.

- Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjajte prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj si dhe me gjobë ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit po ashtu, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë

materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për këtë të pandehur është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizon nga marrëdhënia e punës së tij.

- Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.145/2022 me datë 22.02.2023.

Procembasjtësja,

Mirlinda Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Fatos Sejdiqaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.